



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:109190

Datë: 19.11.2020

Numri i dokumentit: 01282705

P.nr.100/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shere Desku, në çështjen penale kundër të pandehurit: M. (R.) B. , nga fshati Komuna, për shkak të kryerjes së veprës penale: ‘Vjedhja e shërbimeve’ nga neni 314 par 1 te KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/ll.nr 1176/2020, të dt. 26.08.2020, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit te Shtetit: Ersan Qavolli nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të pandehurit M. B., pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt: 27.10.2020, në të njëjtën ditë publikisht shpalli, kurse me datën: 19.11.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: M. B., i lindur me dt. në fsh.K., ku edhe tani banon, nga prindërit babai R., dhe nëna Sh. e vajzërisë B., ka te kryer shkollën mesme, i martuar baba i 6 fëmijëve, gjendjes së dobët ekonomike identifikohet me nr. ,shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTORË

Për shkak se:

Me parë dhe gjerë me datë 30.10.2018 ne fshatinK..... , ne shtëpinë e tij, me qellim të përfitimit ne mënyrë te kundërligjshme është furnizuar me energji elektrike në mënyre të pa autorizuar, duke siguruar shërbime te energjisë me shmangje te pagesës se energjisë se shpenzuar, ne atë mënyre qe gjate kontrollimit nga komisioni i autorizuar i ‘’- it , është konstatuar se i njëjti është hasur ne njehsorë Smart-meter te shkyçur nga distanca, mirëpo i kyçur direkt ne rrjetin elektrik, ku me këto veprime i ka shkaktuar te dëmtuarës ‘’ dëm në vlerë prej 264,06€.

Me qka ka kryer vepër penale ‘Vjedhja e shërbimeve’ nga neni 314 par 1 te KPRK-së .

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 41, 46, 51, 52 dhe 73 si dhe nenit 314 par 1, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së.

G J Y K O N ME DËNIM ME KUSHT

Të pandehurin: M. B., me dënim me gjobë, shuma në vlerë prej 300 (treqind) Euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale.

LIROHET: I pandehuri nga shpenzimet e paushallit gjyqësor për shkak të gjendjes së varfër ekonomike.

UDHËZOHET: Përfaqësuesi i palës së dëmtuar ‘.....’ distrikti në ..., qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj ne kontest te rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzë, PP.ll.nr.1176/2020 të dt: 26.08.2020, për te pandehurin M. B., nga fshati, K..... për veprën penale ‘ Vjedhja e shërbimeve ‘ nga neni 314 par 1 i KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt:27.10.2020 në prezencë të Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit të lartë cekur, ku i njëjti u njoftua me të drejtat e tija, u njoftua me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori lexoi aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar, është deklaruar se e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet. Prokurori i Shtetit, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave të KPRK-së, neni 248.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga Prokuroria e Shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht Prokurorit të Shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës merr aktvendim dhe vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë me aktvendim nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave, por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 69 dhe 70 te KPRK-se.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, gjatë shqyrtimit fillestar E ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në

barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndien keqardhje për veprën e kryer, për të cilën edhe i kërkon falje gjykatës, faktin se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin. Gjykata si rrethane posaçërisht lehtësuese u mor se i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes ka gjashtë fëmijë, dhe është i pa punë, si dhe ka gjendje të rënde shëndetësore, i cili nuk ka aftësi as të punoj.

Ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti në këtë çështje penalo-juridike.

Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 par.1 të KPPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, aprovoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhënien e dënimit meritor, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave ligjore të nenit 453 par.4 të KPPRK-së, lirohet i pandehuri nga shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 të KPPRK-së, u vendos për kërkesën pasurore juridike duke udhëzuar palët e dëmtuara që kompensimin e dëmit ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25 par.2, 26 par.2, 297, 365 dhe 470 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr. 100/2020 më dt: 19.11.2020

Procesmbajtësja
Shere Desku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.